



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE

ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 03-03/1421/18
Br. Prot. 02
Datum 14-05-2018
Prishtine

DATE/A:	14.05.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1409/18
PËR/ZA/TO:	z. Fatmir ISUFAJ, Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Junikut
CC:	z. Agron KUÇI, Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Asfaltimi i rrugës Topilla (Junik-Pacaj) "

I nderuari z. ISUFAJ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "Asfaltimi i rrugës Topilla (Junik-Pacaj) ", me numër të prokurimi: 636-18-2744-521, me nr. të brendshëm: 636-18-011-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Asfaltimi i rrugës Topilla (Junik-Pacaj) ", me numër të prokurimi: 636-18-2744-521, me nr. të brendshëm: 636-18-011-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 14.05.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1409/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Asfaltimi i rrugës Topilla (Junik-Pacaj)*", me numër të prokurimi: *636-18-2744-521*, me nr. të brendshëm: *636-18-011-521*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Junikut.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike të llojit punë, me vlerë të mesme prej 260.000,00 €. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vërejtur se tek rubrika **IV.3.4. tek siguria e tenderit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar vlerën e sigurisë së tenderit 3 % e vlerës së parashikuar të kontratës**. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 29 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP).

Bazuar në nenin 29 paragrafi 4 i (RRUOPP) parashihet se "Shuma e sigurimit të tenderit do të jetë 1-3% të vlerës së parashikuar të kontratës (por jo më pak se 1000 Euro). Shuma do të theksohet në dosjen e tenderit si shumë fikse dhe jo si përqindje". Pra në rastin konkret Autoriteti Kontraktues do duhej që vlerën e Sigurisë së tenderit ta kërkojë në shumë fikse (vlerë monetare) e jo si përqindje.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092 dhe nenin 29 Sigurimi i Tenderit i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të mos i përsërisë praktikat e tilla në të ardhmen.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !